

DEGA: GAZETARI

PROGRAMI I STUDIMEVE: BA

SILABUSET E LËNDËVE: GAZETARI E TELEVISIONIT DHE E RADIOS

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gazetarisë
Titulli i lëndës:	Gazetari e televizionit dhe e radios
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	obligative
Viti i studimeve:	viti i III-të, semestri i V-të
Numri i orëve në javë:	2 + 2
Kreditë ECTS:	6
Koha / Vendi:	Ligjerata (salla 101): e enjte 16- 17:30 Ushtrime (salla 101): e premte 9-10:30 Gr. I 10:30-12 Gr.II
Mësimdhënësi: Asistenti/ja:	Prof. ass. Remzie Shahini-Hoxhaj, PhD Ass. Dren Gërguri, PhD
Të dhënat kontaktuese:	remzie.shahinihoxhaj@uni-pr.edu dren.gerguri@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Kjo lëndë do të ju ofroj njohuri themelore për gazetarinë televizive dhe komunikimin visual. Lënda është dizajnuar në atë mënyrë që t'ju pajisë me pjesën teorike dhe të arriturave shkencore të kësaj fushe të studimit. Përmes kombinimit të ligjëratave dhe pjesës praktike do të mësoni për zhvillimin e televizionit nëpër etapa të ndryshme kohore dhe mësoni për rëndësinë e komunikimit visual. Ligjëratat do të fokusohen në aspektin teorik dhe analitik të kësaj fushe të studimit, përderisa në ushtrime do të ju ofrohet aspekti praktik. Fillimisht do të njiheni me historikun e zhvillimit të televizionit dhe lidhshmërinë e tij zhvillimet shoqërore si në aspektin teknologjik poashtu edhe të ndryshimeve që ka sjell. Më pastaj ligjëratat do të ven në pah teoritë e ndryshme të komunikimit dhe lidhshmërinë e tyre me komunikimin audio-visual. Po ashtu do të thellohem në rëndësinë e televizionit si përmbajtje dhe asaj çfarë na ofron në aspektin e komunikimit. Po ashtu do të shohim raportin e tij me publikun, pastaj ndikimin në

	zhvillime të ndryshme shoqërore e politike, vështirësitë dhe përparësitë e krijimit të televizionit publik dhe atyre private, si dhe ndryshimeve që ka sjell ky lloj i komunikimit në vendet në tranzicion gjegjësisht Kosovë. sferen publike.
Qëllimet e lëndës:	Kjo lëndë ofron fundamentet e gazetarisë televizive dhe komunikimit visuel. Gazetaria e Televizionit është kurs përmes të cilit synohet përgatitja e studentëve të gazetarisë për tregun e mediave elektronike, përkatësisht në rolin e gazetarit të televizionit.

Rezultatet e pritshme të nxënies:	Përmes kësaj lënde synohet që studentët të marrin të gjitha njohuritë e nevojshme teorike e praktike për t'i bërë ata të gatshëm për tregun e mediave elektronike, përkatësisht: ✓ vecorite e gazetarit/es së televizionit në raport me mediat e tjera, ✓ për hulumtimin e lajmit, ✓ për të prodhuar një lajm, ✓ për të xhiruar një intervistë ✓ për informacionet bazike të kamerës, ✓ për informacionet bazë të montazhës, ✓ për rolin e redaktorit dhe për redaktimin e lajmeve, ✓ për rolin e producentit të lajmeve, ✓ për rolin e folësit të lajmeve dhe moderatorit ✓ për aspekte të tjera teknike, por komplementare në përmbushjen e detyrave të gazetarit të televizionit.
-----------------------------------	--

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime	2	15	30
Punë praktike	1	15	15
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	15	2.5
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	8	2	16

Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	3	10	30
Përgatitja për provimin final	3	2	6
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	3	3	6
Projektet, prezantimet, etj.	1	2	2
Total			152,5 orë

Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata do të ndahen në pjesën e ligjërimit, referateve të shkurta dhe pjesë së diskutimit. Studentët do të ftohen mbledhin njohuri nga literatura shtesë për secilën njësi mësimore dhe të prezatojnë dhe shkruajnë një fjalim për çfarëdo teme që ata kanë dëshirë.
Metodat e vlerësimit:	20% Pjesëmarrja në ushtrime 10% Testi mes-semesteral 40% Dokumentari televiziv, storia televizive ose edicioni i lajmeve 10% Detyrat dhe aktiviteti 20% Provimi përfundimtar
Literatura primare:	Buchholz, Alex/ Schult, Gerhard (2002): <i>Gazetaria televizive</i>. Botimi i V. Tiranë K&B, List Verlag. München Bourdieu, Pierre (2015): <i>Mbi televizionin</i>. Tiranë: Pika pa sipërfaqe. Markoff, Sheldon (2000): <i>Menaxhimi krijues i televizionit</i>. IREX/ ProMedia, USAID Shahini-Hoxhaj, R. (2021). <i>Media landscape in Kosovo after 1989: Kosovo as a unique case of media culture in Balkans</i>. In: N. Daskalova and H. Sittig (Eds). <i>Three Decades Later. The Media in South East Europe after 1989</i>. Sofia: Konrad-Adenauer-Stiftung Media Programme South East Europe, pp.125-151. Available at: https://www.kas.de/documents/281902/281951/Three+Decades+Later+-+The+Media+in+South+East+Europe+after+1989.pdf/6faa04eb-2cda-9572-87ad-6d0322b657de?version=1.0&t=1631513601726. Shahini-Hoxhaj, Remzie (2018): Creating a television culture in post-conflict Kosovo: From a balanced public forum to politicization and commercialization. <i>Acta Universitatis Danubius. Communicatio</i>, Vol 12, No 2. Me shume ne: http://journals.univ-danubius.ro/index.php/communicatio/article/view/5239 Shahini-Hoxhaj, Remzie (2018): Facebook and political polarization: An Analysis of Social Media Impact on the Kosovo-Serbia Dialogue. <i>Media Research Journal</i>, Vol.11, issue 3(32). Me shume ne: http://www.mrjournal.ro/docs/R2/32jmr6.pdf

	Shahini-Hoxhaj, Remzie (2015): Kultura e televizionit në Kosovë. Në: Seminari i XXXIV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Më shumë: http://filologjia.uni-pr.edu/getattachment/Seminari/Seminari---Letersi---Vellimi-2.pdf.aspx Zeneli, Alban (2021): MEDIA TRADICIONALE përballë MEDIAS SË RE. Prishtine, Olymp. Sartori, Giovanni (2013): Homo videos – televizioni dhe postmendimi. Tiranë: Dituria. Adelmann Ralf/ Hesse, Jan O/ Keilbach, Judith/ Stauff, Markus/ Thiele, Matthias (Hrsg.) (2002): Grundlagentexte zur Fernsehwissenschaft. Theorie-Geschichte-Analyse. Konstanz. UVK Verlagsgesellschaft mbH.
Literatura shtesë:	Bachmair, Ben (1996): Fernsehkultur. Subjektivität in einer Welt bewegte Bilder. Opladen: Westdeutscher Verlag GmbH. Blumler, Jay G. (Hrsg.)(1992): Television and the public interest. Vulnerable Values in West European Broadcasting. London: Sage Publication Ltd. Boyd, Andrew (2004): Broadcast Journalism. Techniques of radio and television news. 5th edition. Oxford: Focal Press. Briun, Roland de/ Smits, Jan (1999): Digital Video Broadcasting. Technology, Standards and Regulations. Norwood: Artech House. Fiske, John (1994): Television Culture. London/New York. Routledge. Plake, Klaus (2004): Handbuch Fernsehforschung. Befunde und Perspektiven. Wiesbaden: VS Verlag für Sozialwissenschaften/ GWV Fachverlage GmbH. Price, Monroe E./ Raboy, Marc (ed)(2005): Public Service Broadcasting in Transiation. A documenatary reader. Belmont: ThomsonWadsworth. Renner, Karl Nikolaus (2007): Fernsehjournalismus. Entwurf einer Theorie des kommunikativen Handelns. Kostanz: UVK Verlagsgesellschaft mbH.

Plani i dizejnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java 1:	Hyrje Prezantimi i syllabusit
Java 2:	Historia e televizionit në botë
Java 3:	Historia e televizionit në Kosovë
Java 4:	Komunikimi visuel
Java 5:	Apsekti teorik i komunikmit përmes televizionit
Java 6:	Televizioni mes realitetit dhe fiksionit

Java 7:	Programet televizive
Java 8:	Formatet televizive
Java 9:	Televizioni dhe publiku
Java 10:	Televizioni dhe kultura
Java 11:	Televizioni dhe politika
Java 12:	Televizioni si institucion (publik apo privat)
Java 13:	Televizioni në kohë të ndryshimeve gjegj. tranzicioni
Java 14:	Televizioni dhe ekonomia
Java 15:	Rekapitulim i lëndës

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- ✓ Studentët duhet të jenë me kohë në klasë, rregull që vlen edhe për mësimin online.
- ✓ Studentët duhet ta vijojnë rregullisht modulin. Më shumë se tri mungesa ndikojnë në notën përfundimtare dhe duhet shqyrtuar pjesëmarrja juaj në provimin përfundimtar
- ✓ Studentët duhet të jenë social dhe ti sfidojnë kolegët dhe anasjelltas, në suaza të sjelljeve demokratike të një debati.
- ✓ Studentët duhet ti dorëzojnë detyrat me kohë. **Punimet e vonuara nuk do të merren parasysh!**
- ✓ Studentët duhet ti mbajnë telefonat e çkyçur (fikur) gjatë orëve të mësimin, ndërsa gjatë orëve online kamerat e ndezura!

Kopjimi dhe plagjiatura : Studentët të cilët në punimet e tyre kopjojnë apo bëjnë plagjiaturë do të raportohen në organet udhëheqëse të Universitetit!